

VENDIM
Nr. 342, datë 23.5.2012

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 362, DATË 1.4.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, PROCEDURAVE DHE TË DOKUMENTACIONIT
PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 2, e 20 të ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen “Formati tip nr. 5-Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë pa vizë në Republikën e Shqipërisë dhe çfarë dokumenti duhet të paraqesin”, që i bashkëlidhet vendimit nr. 362, datë 1.4.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen:

“Rusi, Kuvajt, Katar, Emiratet e Bashkuara Arabe, Arabia Saudite, me dokumentin pasaportë, për periudhën 25 maj deri në 25 shtator 2012.”.

2. Ngarkohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha